

ARGUMENTUM

news opinion analysis

**Negociatat u çelen,
por si dhe kur do mbyllen?**

- 100 vjet nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike Shqiperi- SHBA
- JO më me histori të retushuar!
- “Ballkani i Hapur” do ndryshojë rajonin përgjithmonë!
- Muzika, “asi nën mëngë” i diplomacisë serbe

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpaket të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexuesve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 ANALIZA E “ARGUMENTUM”

- Negociatat u çelen, por si dhe kur do mbyllen?

07 EDITORIAL

- JO më me histori të retushuar!

08 JO VETEM LAJM

- 100 vjet nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike me SHBA-në.

- “Ballkani i Hapur” do ndryshojë rajonin përgjithmonë!

12 REALPOLITIK

- “Tym i bardhë” në Shkup! Më diskretë me NATO-n! JO e qartë diplomatike! Pragmatizmi mbi parimet!

14 FOKUS

- Muzika, “asi nën mëngë” i diplomacisë serbe

ENGLISH EDITION

17 EDITOR'S TAKE

- DP Chairman Berisha tells PM Rama they are enemies in peaceful protest of opposition in Tirana.

19 TOP NEWS

- Meta expresses gratitude for being president in a 5-year mandate in his last message.

- New President swears-in pledging to be Albanians' servant and guardian of Constitution.

21 REALPOLITIK

- Albania, not only the government in EU! What happened with the Chief Negotiator? Democracy now, not in retrospect! Dick Marty should unite and not divide us! Osmani and Kurti blessed in USA! Diplomatic victory for Erdogan!

23 BALKAN OVERVIEW

- North Macedonia approves the French proposal/ EU: Negotiations open next week.

- Arrogant Vucic wants Kosovo PM Kurti out of office for Pristina-Belgrade talks to go on.

- Montenegro in political crisis as President blasts PM for going ahead to sign accord with Serbian Orthodox Church.

26 INTERVIEW

- Zoran Djukanovic: “The Montenegrin minority in Albania and the Albanian minority in Montenegro to be bridges of communication of our two countries”.

29 IN FOCUS

- Bosnia marks 27th anniversary of Srebrenica genocide.
- Caspian summit and Russia's gas project.



NEGOCIATAT U ÇELEN, por si dhe kur do mbyllen?

Kjo pyetje lind natyrisht pas Konferencës së Parë Ndërqeveritare me BE-në të zhvilluar më 19 Korrik në Bruksel, çka shënoi dhe çeljen zyrtarë të negociatave të antarësimit; duke i dhënë fund pritjes për Shkupin dhe Tiranën, përkatësisht për 17 dhe 8 vjet!

Një ditë kjo e mirë dhe e gëzuar

për të gjithë, miqtë dhe dashamirësit tanë dhe BE-në, e shumëpritur prej kohësh. Është padyshim meritë e qeverisë dhe mazhorancës, por dhe e opozitës dhe forcave të tjera politike, shoqërisë civile, medias, dhe publikut të gjerë kudo.

Megjithatë, të jemi realistë, kjo është një arritje sa e shënuar aq dhe e vonuar, sepse për të arritur në këtë "gur kilometrik" u

deshën mbi 13 vjet pas kërkesës zyrtare për antarësim; ndaj nuk ka vend dhe shpreh për festë triumfale dhe shampanjë.

Përkundrazi, 19 Korriku është më shumë një ditë reflektimi të thellë, për të gjithë, por veçanërisht klasën tonë politike shqiptare të të dy krahëve. Sepse, me përjashtim të 2 – 3 viteve të fundit, është ajo tërësisht përgjegjëse për këtë vonesë historike zh-

gënjyese dhe të mundimshme.

Veç kësaj, çelja e negociatave me BE-në tashmë ka humbur shumë nga "magjia", frymëzimi dhe forca e saj joshëse për disa shkaqe që po i përmendim shkurt më poshtë:

Së pari, koha tejet e gjatë që na është dashur për t'ia mbërritur kësaj dite. Nëse vendet e tjera u antarësuan brenda 15 viteve nga paraqitja e kërkesës zyrtare, ne kemi shpenzuar të njëjtën kohë vetëm për çeljen e negociatave! Mirëpo, ndërkohë, kanë rrjedhur shumë ujra, të cilët kanë turbulluar dhe vetë BE-në. Kjo e fundit i ka forcuar dhe shtuar ndjeshëm kërkesat e saj për shkaqe që i kemi analizuar më parë; ajo ka nxjerrë mësim nga pësimet, ndaj për këtë nuk ka pse e kritikojmë.

Së dyti, ndryshe nga më parë, kur këto negociata zgjatnin maksimumi 5 vjet, dhe pse teorikisht kjo mbetet e pandryshuar, praktikisht nuk ka më data dhe afate, madje as indikative ose të përafërta; sepse ritmin e tyre nuk do ta përcaktojnë më shumë negociatorët teknikë, se sa ecuria pozitive e reformave tona të brendshme.

Rikujtojmë se Mali i Zi, 10 vjet pas nisjes së negociatave, ka mbyllur vetëm 4, ndërsa Serbia vetëm tre kapituj, ndonëse ka 8 vjet që ka çelur negociatat!

Së treti, gjërat kanë ndryshuar rrënjësisht mbas miratimit të Metodologjisë së re të Zgjerimit të Komisionit Europian më 5 Shkurt 2020. Kjo metodologji, që synon rritjen e besueshmërisë, drejtimit politik, dinamikës dhe parashikueshmërisë së proceseve, e thekson më shumë

kondicionalitetin/kushtëzimin dhe kontrollin në çdo etapë të të 35 kapitujve negociues, tashmë të bashkuar në 6 grupe (clusters).

Për pasojë, nëse një vend nuk ecën sipas zotimeve në një fushë të caktuar, Komisioni, ka të drejtë t'i bllokojë ato pa afat, si dhe të japë opinion negativ për kapituj të caktuar, duke ndërprerë punën deri në riparimin e difekteve.

Nëse kjo pastaj "bëhet rrugë", atëherë kalohet në sanksione më të rënda, deri në "rrezimin nga kategoria" dmth heqjen dhe të statusit kandidat dhe kthimin në pikën fillestare (reversibility). E kundërta, nëse gjërat shkojnë

sipas premtimeve dhe afateve, nuk do të mungojë "kulaçi", dmth shpërblimi edhe me fonde monetare.

Për shkak të vetos bullgare, kjo metodologji nuk ka filluar ende nga zbatimi, madje duket sikur është lënë në harresë; por, efektet e saj do të fillojnë të ndihen dhe të vijojnë gjatë gjithë procesit negociues.

Së katërti, ndryshe nga më parë, veç Komisionit Europian, tashmë negociatat dhe gjithë dinamika e procesit do të jenë nën vëzhgimin e rreptë politik dhe teknik të vendeve antare, tashmë jo vetëm të MPJ-ve, por dhe parlamenteve dhe aktorëve të tjerë përkatës; këto të fundit mund të ndërpresin negociatat dhe proceset e tjera, duke propozuar masat përkatëse, çka do ndikojë në kohëzgjatjen e procesit.

Natyrisht zyrtarët europianë kanë të drejtë të thonë, po ju pse merrni anën negative, mendoni dhe pozivisht që gjërat do të ecin mirë e normalisht. Ok, por ja që përvoja e 25 viteve të fundit në rajon, me të gjitha vendet, brenda dhe midis tyre, nuk të jep asnjë shans për optimizëm, qoftë dhe i moderuar.

Ndaj dhe BE-ja nuk ka pranuar të shënojë asnjë afat, por të mjaftohet vetëm duke e përmendur kalimthi zgjerimin, duke i mëshuar më tepër "perspektivës" europiane!

Kësisoj, askush nuk mund të thotë dot, as sot, as nesër, se sa mund të zgjasin këto negociata. Kjo mbasi megjithë përparimet dhe hapat e hedhura, vendi ynë ka shumë hendeqe dhe deficite të mëdha me vendet e BE-së në

Nëse vendet e tjera u antarësuan brenda 15 viteve nga paraqitja e kërkesës zyrtare, ne kemi shpenzuar të njëjtën kohë vetëm për çeljen e negociatave! Mirëpo, ndërkohë, kanë rrjedhur shumë ujra, të cilët kanë turbulluar dhe vetë BE-në. Kjo e fundit i ka forcuar dhe shtuar ndjeshëm kërkesat e saj për shkaqe që i kemi analizuar më parë; ajo ka nxjerrë mësim nga pësimet, ndaj për këtë nuk ka pse e kritikojmë.



të gjitha planet demokratike, politike, ekonomike dhe institucionale! Te ne, sipas burimeve të BE-së, pengesat dhe problemet më të më të mëdha që do të marrin kohë të gjatë janë azili i paligjshëm, korrupsioni, krimi i organizuar, koncensionet, tenderat dhe PPP-të, administrata problematike dhe e tejpolitizuar publike, arsimi, mjedisi, etj; për ironi të fatit, në vend të përmirësimeve, qoftë dhe kozmetike, azili i paligjshëm dhe korrupsioni po shtohen me ritme galopante, përballë “kapitullimit pothuajse pa kushte” të qeverisë; ato do të na qëndrojnë si “çekan te koka” gjatë gjithë procesit të negociatave. Por dhe në drejtësi dhe gjyqësor ku pretendohet se ka përparim, qoftë dhe nga raportet e mëparshme të BE-së, kur “të hapen petët e lakrorit” do të dalin shumë probleme të funksionalitetit të tyre, sundimin e ligjit, etj.

Nuk dua ta helmoj më shumë

atmosferën me shumë e shumë kushte të tjera që përmenden në Kornizën Negociuese të Negociatave, e cila, sipas rregullave të BE-së duhet bërë publike; sidomos Çështjen e Detit me Greqinë, që duket se na i ka “futur të dyja këmbët në një këpucë” me këtë temë që i ngjan një “bombë me sahat”

Së pesti, dhe vetë negociatat në formatin e deritanishëm rrezikohet të spostohen në plan të dytë me zhvillimet e pritshme lidhur me diskutimin dhe miratimin e idesë së hedhur më 9 Maj në Strasburg nga Presidenti Macron dhe ai i Këshillit European Charles Michel për krijimin së shpejti të Komunitetit (Gjeo)Politik European.

Ky Komunitet ka gjasa ta lerë në hije dhe vetë procesin e zgjerimit dhe antarësimit.

Kësisoj, ai përbën dhe një ko-perturë politike të vonesave të mundshme në këtë proces,

me justifikimin se nuk ka pse të kufizohemi vetëm të zgjerimi për realizimin e objektivave strategjike të BE-së; sidomos tani pas rrezikut rus dhe kinez. Edhe pse në parim zgjerimi nuk përjashtohet, fakt është se tash e tutje logoja ose kryefjala do të jetë “përkatësia” dhe “asociimi”, me destinacion antarësimin, por jo detyrimisht dhe pa e ditur askush se kur. Ca më tepër që klima dhe mjedisi kudo në Europë nuk është aspak miqësor ndaj antarësimit të rajonit tonë; për të mos thënë se ai është kthyer në alergji, lodhje dhe “municion” për forcat populiste, ekstremiste dhe euroskeoptike.

Kësisoj, Komuniteti Politik European i akomodon mirë pozicionet dhe i amortizon sulmet dhe goditjet e tyre ndaj forcave moderatore dhe tradicionale pro-europiane dhe pro – integruese.

Për pasojë, tani e tutje nuk do

të kenë rëndësinë e mëparshme negociatat teknike, por proceset dhe rezultatet në praktikë, që të jenë efektive, të prekshme, të matshme dhe të kontrollueshme nga BE-ja, me metodën e "ku-lačit dhe kërbacit"

Nisur nga sa sipër, trysnia e jashtëzakonshme europiane për zhlllokimin e vetos bullgare, që mund e duhej të ishte bërë më parë, më tepër se sa për negocia-tat, u bë për të shpëtuar imazhin dhe besueshmërinë e BE-së; sidomos me shtimin e rrezikut rus dhe kinez dhe ndaj kritikave të shumta se nuk e mban fjalën.

Nëse këto negociata nuk do të ishin çelur qoftë dhe formalisht, atëhere do të hidheshin hije dyshimi dhe mbi vetë idenë e krijimit të Komunitetit Politik European dhe "narrativat" e tij; sepse kritikikët do të thonin se kur BE-ja nuk ishte në gjendje të hiqte një veto, atëhere si mund t'i besojmë asaj për Komunitetin politik?

Me këtë rast, akomodohen dhe kritikave dhe shqetësimet lidhur me depërtimin rus dhe kinez, mbasi të gjithë do të jemi në Komunitetin Politik European.

Së gjashti, me krijimin e Komunitetit Politik do të bjerë dhe trysnia ndaj BE-së për të përshpejtuar procesin e antarësimit, sepse në fund të fundit, duke perifrazuar Presidentin Macron, edhe në rast se nuk banojmë në një shtëpi, jemi bashkë në një rrugë apo rrugicë.

Gjithsesi, kjo mbetet për t'u sqaruar në javët dhe muajt në vijim, deri në Dhjetor, kur pritet të shqyrtohet në detaje dhe të miratohet krijimi i këtij Komuniteti.



Në BE nuk do të hyjnë vetëm qeveria dhe diplomacia (siç ishte përbërja e delegacionit tonë në Bruksel më 19 Korrik), por gjithë Shqipëria, dmth opozita, media, ekonomia, grupet e interesit, dhomat e tregtisë, etj. Mazhoranca të heqë dorë nga gjuha e drunjtë populiste dhe euroskeptike, nga kunjat, thumbat dhe batutat; gjithashtu ajo të rishohë planet e veprimit e t'i verë në zbatim, duke dhënë qysh sot mesazhe konkrete të vullnetit të mirë; duke filluar me tërheqjen e disa projekt-ligjeve të kundërshtuara nga BE-ja...

Së fundi dhe më e rëndësishmja, që procesi i negociatave, të jetë sa më i shpejtë në kohë, klasa jonë politike, qeveria, opozita, media, shoqëria civile, etj lipset të ndryshojnë rrënjësisht kënvështrimet, qasjet dhe mentalitetin e tyre, në funksion të përparimit të negociatave dhe refomave. T'i harrojmë 2-3 vitet e fundit "të mjaltit" kur hiqeshim si fitimtarë dhe viktima, që ankoheshim gjithandej se BE-ja po na trajtonte pa të drejtë e po na vononte. Ky është kapitull i mbyllur. Tani është momenti historik t'i futemi seriozisht punës, me konsensus maksimal politik, me reforma të vërteta, po, po, reforma dhe për Brukselin, Parisin, Berlinin... pra për të 27 vendet antare të BE-së.

Veçse kujdes, në BE nuk do të hyjnë vetëm qeveria dhe diplomacia (siç ishte përbërja e delegacionit tonë në Bruksel më 19 Korrik), por gjithë Shqipëria, dmth opozita, media, ekonomia, grupet e interesit, dhomat e tregtisë, etj. Mazhoranca të heqë dorë nga gjuha e drunjtë populiste dhe euroskeptike, nga kunjat, thumbat dhe batu-

tat; gjithashtu ajo të rishohë planet e veprimit e t'i verë në zbatim, duke dhënë qysh sot mesazhe konkrete të vullnetit të mirë; duke filluar me tërheqjen e disa projekt-ligjeve të kundërshtuara nga BE-ja, si ai i amnistisë fiskale, i medias, etj, përpara se të kalojnë "në sitën" e saj e të na kthehen mprapsht, me të papritura dhe pasoja të pakëndshme. Le të shpresojmë, aq sa mundet, që mesazhet dhe ndjesa e Kryeministrit Rama më 20 Korrik në Tiranë nuk janë më për show apo sa për të "larë gojën" por do të "përkthehen" në vazhdimësi në akte dhe fakte konkrete.

Festa mbaroi, tani kërkohet punë dhe përpjekje të pandërprera me reformat dhe negociatat; këto të fundit jo më si krushqi, dasëm, martesë apo ndeshje futbolli; por si një vrapim kolektiv në distancë të gjatë dhe me pengesa. Nuk na kërkohen rekorde, shkëlqim apo të dalim mbi të tjerët; boll të "plotësojmë normat" për këtë garë, ta përfundojmë atë në kohë, ama jo "me shpejtësi breshke" si deri tani, pa vonesa dhe mungesa; me qëllim që përgjigja e pyetjes së shtruar qysh në titullin e shkrimit të mos shtyhet në kalendat greke.

JO MË ME HISTORI TË RETUSHUAR!

Dihen tashmë metodat dhe praktikat e shëmt-uara të periudhë moniste, kur retushoheshin, dmth ndryshoheshin, korrigjoheshin dhe hiqeshin fare pamje, foto dhe kronika të ndryshme të personaliteteve historike. Vetëm se nuk i pëlqenin pushtetit të atëhershëm, i cili i kishte etiketuar dhe dënuar egërsisht si armiq, tradhtarë dhe spiunë me pseudo argumenta absurde.

I kemi parë të cunguara fotot dhe pamjet e shpalljes së Pavarësisë më 1912, të çlirimit të vendit e deri në vitet 90 të ngjarjeve dhe përkujtimeve historike, ku mungonin jo një e dy, por me dhjetra protagonistë politikë dhe historikë. Retushimi ishte bërë praktikë e zakonshme, e cila synonte të linte në harresë dhe të injoronte figura të shquara me kontribut historik në ngjarjet më madhore dhe emblematike të kombit tonë.

Mirëpo, për fat të keq, po shihen tendenca, deri te ringjallja e këtyre dukurive të dëmshme. Kjo u pa dhe në festimet e 100 Vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me SHBA-të dhe në Koncertin festiv më 28 Korrik. Ra në sy se në pamjet e videot që u shfaqën si ilustrim i historikut të këtyre marrëdhënieve tona dy dhe shumëpalëshe nuk u shfaqën sekuenca qoftë dhe minimale nga momentet e rivendosjes së marrëdhënieve mes dy vendeve tona në Mars 1991, në Departamentin e Shtetit, nga vizita e Presidentit Bush në Tiranë më 2007, ngjarja më e madhe dhe më e shënuar në këto marrëdhënie, antarësimin tonë në NATO, etj.

Kjo vetëm e vetëm sepse në ato dhe në shumë ngjarje të tjera, ishte pro-



tagonist Sali Berisha, i cili është shpallur – non – grata! Prej tij “e pësoi” dhe ish Presidenti Bush, të cilin gjithashtu nuk do ta shihnim e dëgjoni, po të mos ishte një mesazh që ai dërgoi me atë rast.

Kjo nuk la shije të mirë dhe nuk tingëllon fare demokratike. Sepse një ish lider dhe protagonist madhor politik i 32 viteve të fundit, si ai dhe të tjerë mund të pësojë aksident politik, të tradhëtojë kursin e tij, madje të dënohet dhe me heqje lirie; por ama emri, kontributi dhe gjurmët e tij në histori mbeten; ato nuk mund të fshihen dhe retushohen nga askush!

Ndryshe historia do të bjerë preh e tekave dhe qejfeve të çastit, të njerit apo të tjetrit; ajo do të kthehet në një mall të zakonshëm, që kushdo mund t’ia ndryshojë etiketën, ta monopolizojë dhe privatizojë si pa të keq. Kështu duhej e do vepruar në të ardhmen me Sali Berishën dhe emra të tjerë, sepse siç e kemi nisur, me siguri që “non – grata” dhe dënimet për korrupsionin, i cili te ne nga “domethënës” para 10 e më shumë

vitesh tanimë është bërë ulëritës do të shumëfishohen.

Emri dhe kontributi i tij nuk mund të mohohen, por duhen përmendur në çdo rast, ashtu siç ishte, pse jo dhe “burrë shteti”, siç e pati etiketuar me tepëri një ish Ambasador amerikan, por dhe me dritë hijet e veta deri te shpallja “non – grata”! Ndryshe do t’i bëhej atentat historisë!

Si përfundim, asnjë devijim, retushim subjektiv të historisë dhe marrëdhënieve me vendet e tjera, duke filluar nga SHBA-të. Ndryshe, nëse vazhdohet më tej me retushime të këtij lloji, dallimi midis një shteti demokratik dhe autoritarist do të bëhet dhe më i vështirë.

Sa i takon SHBA-ve, mjafton të rikujtojmë rastin e ish Presidentit Nikson, i cili pavarësisht nga skandali i shekullit i Watergate-it, jo vetëm nuk u rertushua në asnjë çast, por ai kujtohej dhe nderohej deri në vdekjen e tij, natyrisht me qëndrime kritike. Dhe sot vlerësohet si ndër presidentët më të shquar amerikanë.

100 VJET

nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike

ME SHBA-në

Sot (28.07) Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara kujtojnë 100-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy vendeve. Ndonëse me një shkëputje gati pesë dekadash që nga lufta e Dytë Botërore e deri me rënien e komunizimit ku u rivendosen sërish këto marrëdhënie. Ndërsa sot Shqipëria është aleat dhe partner strategjik i SHBA-së.

Në një rend kronologjik kujtojmë se Shtetet e Bashkuara vendosën marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë në vitin 1922, pas pavarësisë së saj të vitit 1912 nga Perandoria Osmane.

Ambasadori i parë amerikan në Tiranë ishte Ulysses Grant Smith, i cili e nisi misionin diplomatik më 4 dhjetor 1922.

Ambasadori i parë shqiptar në Uashington ishte Faik Konica, i cili u emërua në këtë detyrë në vitin 1929 nga Ahmet Zogu.

Marrëdhëniet diplomatike SHBA-Shqipëri u ndërpre në vitin 1939 për shkak të okupimit të Shqipërisë nga Italia (1939-43) dhe Gjermania (1943-44) gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pas luftës, Shqipëria pa 40 vjet izolim nën udhëheqësin komunist, i cili vdiq në 1985.



Ambasada e Sh.B.A. në Tiranë u hap më 1 tetor 1991, me Kristofer Hill si i Ngarkuar me Punë dhe i pasuar nga Ambasadori i SHBA Uilliam Eduin Rajerson, i cili ia paraqiti kredencialet e tij qeverisë së Shqipërisë më 21 dhjetor 1991.

Në ceremoninë historike në vitin 1991 për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, i cili rivendoste marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve, Ndihmës Sekretari i atëhershëm i Shtetit për Çështjet Evropiane dhe Kanadeze Rejmond G.H. Saitc, tha “marrëdhënia midis vendeve tona fillon me vitet e hershme të këtij shekulli, kur Presidenti [Udrou] Uillson i ofroi mbështetjen amerikane shtetit të ri shqiptar.

Më 11 qershor 1991, ish Sekretari i Shtetit Xheims A. Bejker III

ishte zyrtari i parë i nivelit të lartë i SHBA, që vizitonte Shqipërinë pas periudhës së gjatë të izolimit të vendit. Që nga ajo kohë, marrëdhëniet SHBA-Shqipëri kanë përparuar e janë rritur, dhe Shqipëria është bërë një nga aleatet më të palëkundura të Amerikës, sidomos në luftën globale kundër terrorizmit.

Për këtë ngjarje një shekullore u zhvillua sot në Tiranë ceremonia me rastin e 100- vjetorit të marrëdhënieve diplomatike Shqipëri-Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ambasadorja e SHBA-së Shqipëri, Yuri Kim u shpreh në fjalën në konferencë se “si sot një shekull më parë disa vite pasi presidenti deklaroi se në Konferencën e Parisit se Shqipëria do të jetë një komb i pavarur dhe



sovrani. Komisionari amerikan në Shqipëri pati nderin t'i përcjellë ministrit Xhafer Ypi njohjen e Shqipërisë si shtet i pavarur nga SHBA duke njohur njëri-tjetrin si kombe. Më 28 korrik 1922, Shqipëria dhe Amerika ndezën një pishtar të shenjtë që është përcjellë në breza”

Kim shtoi sa gjatë ditëve të errëta të komunizmit ai pishtar i shenjtë u ruajt nga shqiptarët, dhe madje disa paguan çmimin më të lartë.

“Ata dhe ne që jemi mbledhur këtu sot kemi nderin e madh që të trashëgojmë atë pishtar dhe ta ngremë ata lart së bashku duke bërë atë që të ngrohë miqësinë mes popullit amerikan dhe shqiptar dhe të ndriçojë rrugën tonë përpara në shtegun tonë të përbashkët si miq dhe aleatë të vërtetë. Ndërsa shenojmë një shekull marrëdhëniesh diplomatike nderojmë të gjithë amerikanët dhe shqiptarët që erdhën para nesh dhe kontribuan në Shqipëri. Veçanërisht ata shqiptarë guximtarë që paguan çmimin e lirisë dhe të miqësisë duke dhënë jetën e tyre”, tha ajo.

Kim shtoi se shumë gjëra kanë ndryshuar në 100 vite, por Shtetet e Bashkuara kurrë nuk janë lëkun-

Ambasadori i parë amerikan në Tiranë Ulysses Grant Smith dhe Ambasadori i parë shqiptar në Uashington Faik Konica, 1922



Ambasadorja amerikane në Shqipëri Znj. Yuri Kim

Ata dhe ne që jemi mbledhur këtu sot kemi nderin e madh që të trashëgojmë atë pishtar dhe ta ngremë ata lart së bashku duke bërë atë që të ngrohë miqësinë mes popullit amerikan dhe shqiptar dhe të ndriçojë rrugën tonë përpara në shtegun tonë të përbashkët si miq dhe aleatë të vërtetë.

dur nga besimi për një Shqipëri të pavarur dhe sovranë.

Kryeministri Edi Rama

Kryeministri Rama theksoi se “ai është edhe momenti kur mori jetë kjo marrëdhënie kaq speciale. Nuk besoj se ndodh në ndonjë vend tjetër që gjithë qeveria dhe gjithë paria e vendit të mblidhen me ambasadorin e SHBA dhe të kremtojnë ditën kur kanë firmosur marrëdhëniet diplomatike. Kjo nuk e bën aspak të pakuptueshme apo qesharake këtë që ndodh në vendin tonë sepse ndryshe nga të gjitha vendet e tjera pa asnjë përjashtim në këtë marrëdhënie ka hyrë në mes një histori e pangjashme me asgjë tjetër që ka përcaktuar edhe këtë nivel thellësie të marrëdhënies sonë me SHBA”.

Sot, vijoi Rama, jemi këtu për 100-vjetorin se pikërisht si sot 100 vjet me parë në 28 korrik 1922 mbërriti dokumenti zyrtar që njoftonte qeverinë shqiptare se SHBA e njohin qeverinë shqiptare dhe Maxuell Blake emërohet ambasadori i parë në Shqipëri.

“Në fakt nuk është një 100-vjetor që vjen pas një miqësie të lumtur, por vjen pas një historie që siç thashë është përcaktuese në këtë marrëdhënie sot. Historia e ndarjes me dhunë, me zjarr e me hekur e Shqipërisë dhe shqiptarëve nga bota dhe shkëputjes totale të çdo lidhje me SHBA madje e vendosjes së SHBA në shënjestrën e përditshme të diktaturës komuniste”, nënvizoi Rama.

Nëse do ta parafytyronim për një moment të vetëm rrugëtimin e këtyre 30 viteve, pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe pse mund të kishim lirinë dhe mund t'i kishim hapur vetes rrugën për



Kryeministri i Shqipërisë
Z. Edi Rama

Shtetet e Bashkuara në Shqipëri janë në shtëpinë e tyre sepse kështu e kanë vendosur shqiptarët dhe sepse kështu e ka dashur gjithë kjo rrugë ku pa zërin e SHBA-së në atë vit kur Fan Noli iu lut përulësisht presidentit Wilson, Shqipëria mbase nuk do ekzistonte.



të ndërtuar demokracinë, e marrim vetë me mend se çfarë do ishte Shqipëria sot; gjithçka tjetër, por jo një vend ku po zhvillohet një reformë e thellë në drejtësi, gjithçka tjetër, por jo një vend ku vazhdon përpjekja e përditshme për t'u ndarë nga e shkuara, gjithçka tjetër, por jo një vend dhe popull i mbrojtur nga vetë xhagajdurët e tij, që kanë qenë historikisht arsyeja kryesore pse shqiptarët nuk kanë mundur të nxjerrin në pah të gjithë potencialin e tyre”, nënvizoi Rama.

Sot, shtoi Kryeministri Rama, janë të panumërta arsyet, pse bazuar në historinë e këtyre 30 viteve, kjo është një marrëdhënie e pazëvendësueshme strategjike dhe arsyet pse ne duhet ta durojmë me buzëqeshje, madje dhe me kënaqësinë, protagonizmin e ambasadorëve amerikanë në Shqipëri.

“Është shumë e thjeshtë. Shtetet e Bashkuara në Shqipëri janë në shtëpinë e tyre sepse kështu e kanë vendosur shqiptarët dhe sepse kështu e ka dashur gjithë kjo rrugë ku pa zërin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në atë vit kur Fan Noli iu lut përulësisht presidentit Wilson, Shqipëria mbase nuk do ekzistonte. Pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Shqipëria sot nuk do ishte as anëtare e NATO-s dhe as anëtare e Këshillit të Sigurimit”, theksoi Rama.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Bajram Begaj

Presidenti i Republikës Bajram Begaj, në fjalës së tij, në konferencën e organizuar sot në Tiranë, me rastin e 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, u shpreh se “është një moment i historisë sonë që lidhet me të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen e këtyre marrëdhënieve”.

“Edhe për mua, ashtu si edhe për parafolësit, është kënaqësi e veçantë që sot mblidhemi edhe një herë për të kremtuar 100-vjetorin e lidhjeve të marrëdhënieve diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, partnerin tonë më të madh strategjik. Nuk do të doja të përsërisja aspak çka u tha më parë, por gjithsesi nuk mund të rri dot pa evidentuar (edhe njëherë) një moment të historisë, që lidhet me të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen e këtyre marrëdhënieve”, tha Begaj.

“Pa dyshim, vijoi Presidenti, që rolin më të rëndësishme në krijimin e këtyre marrëdhënieve e ka luajtur Presidenti Uilson. Emër që ka fituar mirenjohjen e gjithë



Presidenti i Shqipërisë
Z. Bajram Begaj

Këto janë vite të cilat e kanë shënuar historinë e vendit tonë, ndërsa miqtë tanë amerikanë na kanë frymëzuar në rrugën drejt zhvillimit dhe forcimit të demokracisë”,



zemrave shqiptare – siçthoshte Noli, i cili bashkë me Konicën dhe Vatranët e tjerë, besonin fort në politikën amerikane të kohës dhe vunë gjithçka patën nëshërbim të miqësisë dhe bashkëpunimit midis dy vendeve”.

Begaj vuri në dukje, se ishte Presidenti Uilson që, me vizionin dhe përkushtimin e tij për një rend të ri botëror dhe një diplomaci të hapur, u bë mbrojtësi më i fuqishëm i pavarësisë dhe moscopëtimit të trojeve të Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris.

“Ishte pikërisht kjo mbështetje e fuqishme që hodhi bazat më pas për formalizimin e marrëdhënieve diplomatike si sot 100 vjet më parë. Njëqind vite në historinë e trazuar të një vendi nuk janë pak. Këto janë vite të cilat e kanë shënuar historinë e vendit tonë, ndërsa miqtë tanë amerikanë na kanë frymëzuar në rrugën drejt zhvillimit dhe forcimit të demokracisë”, theksoi në fjalën e tij Presidenti.

“BALLKANI I HAPUR”

do të ndryshojë rajonin përgjithmonë!

Me Ballkanin e Hapur do ndryshojmë rajonin përgjithmonë”, kështu theksoi Kryeministri Rama gjatë fjalës së tij mbajtur me rastin e 100 vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike Shqiperi-SHBA.

Kryeministri Edi Rama thotë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë paraqitur një dokument që ka për qëllim thellimin e mëtejshëm të partneritetit strategjik mes Shqipërisë dhe SHBA-së, duke u shprehur se rajoni i Ballkanit do të ndryshojë falë nismës “Open Balkan”, që ai tha se tashmë ka mbështetjen 100% të SHBA-ve.

“Është vërtet nder dhe privilegj që kemi arritur të nënshkruajmë një marrëveshje partneriteti strategjik, dhe së fundmi kemi marrë nga Uashingtoni një dokument për ta thelluar partneritetin strategjik. Shqipëria është baza politike e SHBA në rajon. Ne do ta ndryshojmë rajonin dhe me Ballkanin e Hapur që është një projekt 100% i dakortësuar me SHBA, do të bëjmë të mundur që e shkuara të mos jetë më kërcënim për Ballkanin, por të jetë vetëm një thesar dijes se si e shkuara të mos përsëritet”, u shpreh Rama.

Në fakt kjo duket si një kundërpërgjigje ndaj Presidentit të Malit të Zi Milo Gjukanoviç, i cili në një intervistë për portalin “Autonomija” tha se “Ballkani i Hapur” duket si një alternativë për vendosjen në jetë të planit të Beogradit për “Botën serbe”

Është një projekt “shumë kontrovers” dhe skenar alternativ për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor jashtë Bashkimit Evropian, tha Ai.

Madje presidenti malazez theksoi se qëllimi i autorëve të idesë së Ballkanit të Hapur është zhdukja e Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut dhe shtoi se sigurisht që do të përfundonte me “luftë dhe njëfarë gjenocidi”.

Në fakt Gjukanoviç si presidenti i një vendi tashmë anëtar i NATO-s, dhe aleat i SHBA-së nuk do të mund ti lejonte vetës të “akuzonte” pikërisht SHBA-të se po rrezikonin një gjenocid në Ballkan me projektin e “Open Balkan”, i njëjti projekt që Kryeministri Rama e truembeon si një nismë që ka mbështetjen 100% të SHBA-ve (!)



Nuk është hera e parë që paraqiten projekte apo vizione nën emrin e SHBA-së por në fund nuk e kanë marrë bekimin e tyre.

Kujtojmë vitin 2018 ku u propozua shkëmbimi i territoreve me emërtimin “korrigjim kufijsh” nga Ish presidenti i Kosovës Z. Hashim Thaçi. Edhe atëherë u përfol se kjo ide kishte mbështetjen e Presidentit amerikan Donald Trump por më vonë ky fakt do të hidhej kategorikisht poshtë nga Ish-emisari amerikan për dialogun Kosovë-Serbi, Richard Grenell.

Edhe në rastin e iniciativës “Open Balkan”, SHBA-të në deklaratat e tyre kanë theksuar disa herë që vlerësojnë çdo bashkëpunim ndërmjet shteteve të Ballkanit por që duhet të plotësojnë dy kritere kryesore, së pari gjithëpërfshirjen e 6 shteteve të Ballkanit dhe së dyti që ky bashkëpunim të jetë vetëm ekonomik.

Kështu theksoi i dërguari i posaçëm amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, në takimin e Ohrit me 7-8 qershor, tha se Shtetet e Bashkuara e mbështesin nismën “Ballkani i Hapur”, duke nënvizuar se çdo nismë duhet të përfshijë të gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor në nivel të njëjtë. Me rëndësi është që të mbetet projekt ekonomik në mënyrë që të përqendrohet në krijimin e mundësive për njerëzit e rajonit dhe të keni përkrahje më të madhe”.

Një gjë është e sigurtë, Kryeministri Rama ka të drejtë kur thotë se me “Ballkanin e Hapur” rajoni do ndryshojë përgjithmonë, por pyetja është si do ndryshojë ai?

Urojmë që “profecia” e Gjukanoviç të mos bëhet realitet...

“Tym i bardhë” në Shkup! Më diskretë me NATO-n! JO e qartë diplomatike! Pragmatizmi mbi parimet!

REALPOLITIK “FLASH” NO. 49; 7 – 17 KORRIK 2022

EKSKLUZIVISHT PER ARGUMENTUM

Shkurt dhe Shqip mbi 4 ngjarjet kryesore diplomatike me vetëm 1000 fjalë nga analisti i njohur diplomatik dhe “Mjeshtër i Madh”

DR. JORGJI KOTE

1. “Tym i bardhë” doli më në fund në Shkup më 16 Korrik! Me 68 vota pro u votua propozimi kompromis francez. Kështu i çelët rruga çbllokimit bullgar, Konferencës së Parë Ndërqeveritare më 19 Korrik në Bruksel dhe çeljes së negociatave me vendin tonë.

Mirëpo për Shkupin, dhe tani pas 17 vitesh pritje, asgjë nuk është ende e sigurt. Sepse për të çelur negociatat, atij i duhet të miratojë më vonë ndryshimin kushtetues për përfshirjen e pakicave bullgare, të cilën opozita maqedonase dhe ditën e votimit e deklaroi se do ta kundërshtojë me forcë, duke mos lejuar 2/3 e votave; madje, ajo ka paralajmëruar zgjedhje të parakohshme dhe anulimin e gjithë këtij procesi.

Ndërsa për Shqipërinë pritja 8 vjeçare mori fund. Çelja e negociatave është vërtet arritje e shënuar, por tejet e vonuar. Ndaj nuk të ngroh si më parë dhe për shkak të rrugës së gjatë që do të na duhet të bëjmë me plot pengesa, të panjohura dhe ndërprerje. Ndryshe nga më parë, kur ato zgjatnin deri në 5 vjet, tani nuk ka më afate të tilla. Për herë të parë do të zbatohet Metodologjia e re e Zgjerimit e BE-së e miratuar në shkurt 2020; në bazë të saj, negociatat mund t'i ndërpresë dhe një vend i vetëm, kur një vend ka probleme. Shihni Serbinë dhe Malin e Zi, që



ndonëse kanë 8 dhe 10 vjet në negociata kanë mbyllur vetëm 4 dhe 3 nga 35 kapituj! Së fundi, krijimi i Komunitetit Politik European mund t'i lërë në hije negociatat, meqenëse përparësi do të kenë proceset dhe rezultatet konkrete!

2. Më diskretë me NATO-n! Zakon i keq i liderëve tanë që i bëjnë publike disa lëvizje dhe hapa diplomatikë, përpara se të bisedojnë me homologët Euro-Atlantikë. Më 13 Korrik Kryeministri Rama ishte në selinë e NATO-s në Bruksel, ku u takua me Sekretarin e Përgjithshëm, Jens Stoltenberg, me të cilin dha dhe një Konfer-

encë Shtypi rutinë.

Disa ditë përpara se të shkonte në Bruksel, ai bëri publike ofertën për të venë në dispozicion të Aleancës një bazë ushtarake detare në Porto Romano. Mirëpo, ra në sy se ndryshe nga Rama që e përmendi por dhe ai në fund atë, Stoltenberg as që e zuri në gojë këtë temë. Ndër shkaqet e ndryshme, kryesorja sepse është në traditën e NATO-s që të jetë diskrete për këto tema; sepse ato përfshijnë shumë komponentë politikë, ekonomikë, të sigurisë, etj, që duhen shqyrtuar përpara se të thuhet PO ose JO. Ndërkohë, nga ana jonë, këto

aspekte vazhdohet të shihen nën prizmin e periudhës së Luftës së Ftohtë. Atëhere këto baza kishin shumë më tepër rëndësi, si “vendi i vetëm socialist në botë”, të rrethuar ngado nga armiq. Ndërsa sot, ne rretohemi nga vende aleate, ku janë vendosur prej kohësh shumë baza ushtarake. E megjithatë ato vende nuk bëjnë protagonistin si ne, ndonëse në renditjen e “Global Firepower” jemi të 115 nga 141 vende gjithsejt.

Në të tilla raste është më mirë që këto probleme fillimisht të diskutohen në kanalet e duhura zyrtare dhe vetëm në fund, kur projekti të jetë miratuar e gati për zbatim, mund të bëhet marketingu i duhur politik dhe diplomatik.

3. “Jo” e qartë diplomatike ishte largimi nga salla sapo do të fliste Kryeministri Rama e ambasadorit gjerman dhe ambasadores franceze në Tiranë gjatë takimit të organizuar më 15 Korrik lidhur me projekt-ligjin kundërthënës të amnistisë fiskale. Në fakt, ai takim ishte thirrur si konsulencë me grupe interesi, dhoma tregtare, etj lidhur me këtë ligj. Mirëpo diskutimet e zv. Kryeministrit Ahmetaj dhe Ministres së Financave Ibrahimaj treguan se tashmë ai ishte “fakt i kryer”; ndaj, nuk bëhej fjalë për konsulencë, ca më pak për oponencë nga askush! Kërkohej vetëm bashkëpunim dhe mbështetje, madje dhe nga vetë BE-ja për zbatimin e shpejtë të këtij ligji problematik. Mirëpo, Ambasadorët e dy vendeve më të mëdha të BE-së, nuk mund të bëheshin pale në këtë mesele, sepse siç e pohuan vetë mbështetësit në qëndrimin kundërshtues të BE-së dhe FMN-së për atë projekt-ligj, ndaj dhe u larguan, duke e lënë pa fjalë mikpritësin e takimit. Të dy ambasadorët më vonë njoftuan

Çelja e negociatave është vërtet arritje e shënuar, por tejet e vonuar. Ndaj nuk të ngroh si më parë dhe për shkak të rrugës së gjatë që do të na duhet të bëjmë me plot pengesa, të panjohura dhe ndërprerje. Ndryshe nga më parë, kur ato zgjatnin deri në 5 vjet, tani nuk ka më afate të tilla. Për herë të parë do të zbatohet Metodologjia e re e Zgjerimit të BE-së e miratuar në shkurt 2020; në bazë të saj, negociatat mund t'i ndërpresë dhe një vend i vetëm, kur një vend ka probleme.

me lezet dhe finesë diplomatike se ishin larguar për shkak të një angazhimi tjetër! Angazhim më të madh se aktiviteti dhe fjala e Kryeministrit Rama? Pastaj, pse nuk ikën disa minuta më parë të paktën, por pikërisht në momentin që ai do merrte fjalën?

Padyshim, ky përbën një ndër rastet klasike të “Jo”-së së ngadalshme diplomatike” Ajo bëhet në heshtje, pa bujë, me justifikime të llojit të lartpërmendur. Fatkeqësisht liderët tanë nuk duan ta kuptojnë këtë JO. Kështu ndodhi dhe në fillim të muajit Maj në Berlin, kur Kancelari Scholz, në përgjigje të reklamës së KM Rama për “Ballkanin e Hapur” as që e zuri fare në gojë, por ligjëroi gjatë për Procesin e Berlinit! Ndaj, ju lutem, mos prisni të na e thonë hapur dhe me gërma të mëdha “JO”; nuk ndodh kjo me diplomacitë e konsoliduara perendimore. Pastaj, BE-ja kur të dojë “na kap me qerre”, duke filluar nga negociatat që mezi pritëm të çelen, të cilat mund të ndërpriten në çdo moment, sa herë “t’i hipim kalit së prapthi”!. Kujdes, është tepër vonë për sovranistët, populistët dhe euroskeptikët, qofshin ata dhe në majë të piramidës së përkohshme qeveritare!

4. Pragmatizmi, pastaj parimet në politikën e jashtme u konfirmuan qartë dhe në vizitën zyrtare të Presidentit Biden në Arabinë Saudite më 15 Korrik. Ndryshe nga sa kishte premtuar në fushatën zgjedhore, se do izolonte Princin Trashëgimtar Muhammed bin Sahlam, si përgjegjës për vrasjen barbare të gazetarit të « Washington Post » Kashhoggi më 2018, kritikave dhe paralajmërimeve të shoqatave të të drejtave të njeriut, Biden u takua me Princin. Kësisoj, dëshmoi dhe njëherë se sot pragmatizmi dhe realpolitika janë të parat, pastaj, në funksion të tyre vijnë parimet dhe moralizimi, demokracia dhe shteti i të drejtës.

Agresioni rus ndaj Ukrainës e ka bërë dhe më të dukshëm dhe të nevojshëm këtë realitet. Ndihej sa saudite është jetike, sidomos për stabilizimin e tregjeve të naftës dhe qëndrimin ndaj Iranit. Edhe pse Princi akuzohet për vrasjen e gazetarit, sërish ai përbën alternativën më të mirë në atë vend strategjik. Ndaj, sipas Realpolitikës, “derrit duhet t’i thuash dajë”. Këtë bëri dhe Bideni në Arabinë Saudite, ndryshe do të duhej “t’i binte murit me kokë”.

Muzika, “asi nën mëngë” i diplomacisë serbe

Muzika është “grishja” diplomatike serbe ndaj krerëve të shteteve të ndryshme që vizitojnë Beogradin.

Pikërisht në darkat me rëndësi ku gërshetohen interesat politike dhe ekonomike, Serbia nxjerr “asin nën mëngë” për të zbutur zemrën edhe të atyre liderëve me hije të rëndë në dukje por që “thyhen” para shpirtit të zjarrtë ballkanas.

Muzika ky ushqim shpirtëror, që te deh zemrën e mendjen është asi i artë diplomatik që Serbia e hedh herë pas here në tavolinën e interesave gjeostrategjike.

Dikush mund ta quajë një mikpritje tipike ballkanase të cilët shquhen për bujarinë, traditat dhe pasurinë folklorike ku natyrisht edhe Serbia është pjesë e rëndësishme e saj.

Megjithatë, ajo që Serbia shpërfaq herë pas here nuk ka të bëjë me traditat më shumë se sa me interesat politiko-ekonomike të saj.

Në rastin konkret vizita e kryeministrit spanjoll, Pedro Sanchez në Beograd në kuadër të turit të tij të parë në Ballkanin Perëndimor, ka rizgjuar sërish traditën serbe të të kënduarit ekskluzivisht për të ftuarin special.

Pas takimit zyrtar me Vuçiç, kryeministri spanjoll, Pedro Sanchez ka deklaruar në konferencë për media bashkë me presi-



dentin serb, se kur bëhet fjalë për çështjen e Kosovës, Spanja qëndron në anën e Serbisë.

“Spanja e mbështet Serbinë kur bëhet fjalë për çështjen e Kosovës dhe do të jetë gjithmonë me të në mbrojtjen e parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe integritetit territorial dhe sovranitetit”, ka thënë Sanchez.

Qeveria spanjolle ofron mbështetje të vazhdueshme dhe të vazhdueshme për rrugën evropiane të Serbisë, si dhe për integritetin territorial të vendit tonë, për të cilën Beogradi është mirënjohës, tha mbrëmë presidenti Aleksandar Vuçiç, i cili mbrëmë priti për darkë kryeministrin spanjoll.

E pra nuk mund të kishte dhuratë më të bukur për Vuçiç se sa kjo deklaratë e liderit të një vendi European që ende nuk e njeh

Kosovën, ndaj dhe nikoqiri Vuçiç e surprizoi ldierin spanjoll me një këngë spanjolle

Vuçiç ka postuar në profilin e tij në Instagram një foto nga darka e organizuar për nder të kryeministrit spanjoll, ku këngëtarja Jelena Tomašević interpretoi këngën “Oro” në spanjisht.

“Ne kemi përgatitur një surprizë për një mik të dashur. Jelena Tomasević-i ynë i këndoi këngën ‘Oro’ në spanjisht, e cila dha një ton të veçantë për këtë mbrëmje”, ka shkruar Vuçiç dhe e ka falënderuar për performancën e mrekullueshme.

Ndër vite në delegacionet e shteteve me rëndësi, darkat e shtruar nga pala serbe grishen me një këngëtar special që ka një repertor të gjerë.

Kjo jo nga një këngëtar profesion-

ist si në rastin e pritjes së Kryeministrit spanjoll, por nga një “këngëtar” i veçantë me peshë të rëndësishme politike siç ishte rasti i ish-Ministrit serb të Punëve të Jashtme, Ivica Daçiç

Ivica Daçiç, si kryediplomat serb ka kënduar në disa nga darkat zyrtare të shtruar në Beograd.

Kujtojmë rastin e vizitës së Presidentit turk Erdogan ku Daçiç këndoi disa këngë për nder të Presidentit Erdogan dhe delegacionit turk.

Dhe jo këngë serbe apo këngë të tjera të famshme, por Daçiç di të “qëllojë” mu në zemer, ai teksa i afrohet tryezës ku ndodhej Presidenti turk Recep Tayyip Erdogan e surprizoi duke kënduar turqisht këngën “Osman Aga”, një këngë e kënduar në shumë vende ballkanike.

Po ashtu kujtojmë jehonën që mediat greke i kanë bërë lajmit për darkën e shtruar për ministrin e tyre të Jashtëm, Nikos Kotzias gjatë vizitës së tij në Serbi, ku Ivica Daçiç i i ka befasuar të gjithë me një këngë në gjuhën greke.

“Gjatë një dreke shtruar për nder të homologut grek Nikos Kotzias, Ivica Daçiç papritur mori mikrofonin dhe nën tingujt e orkestrës filloi të këndojë rrjedhshëm në greqisht këngën e njohur “Mos m’u zemëro syri im”, të këngëtarit të mirënjohur grek Jorgo Dalaras”, - shkruajnë mediat greke.

Po sipas tyre, në momentet që Daçiç ka nisur të këndojë, edhe ministri grek Nikos Kotzias është ngritur në këmbë dhe së bashku me Ivica Daçiç kënduan këngën në prani të të ftuarve të tjerë.

E në fund të këngës, ai nuk e ka harruar traditën e vjetër greke,

“Gjatë një dreke shtruar për nder të homologut grek Nikos Kotzias, Ivica Daçiç papritur mori mikrofonin dhe nën tingujt e orkestrës filloi të këndojë rrjedhshëm në greqisht këngën e njohur “Mos m’u zemëro syri im”, të këngëtarit të mirënjohur grek Jorgo Dalaras”.

duke thyer një pjatë.

Nuk ka të ndaluar Ivica Daçiç, ku tashmë i ndërjegjësuar për talentin e tij si “bilbil i diplomacisë” serbe nuk mund të mos i këndon të Presidentit rus Vladimir Putin.

Kështu në darkën zyrtare të shtruar për nder të presidentit të Rusisë, Vladimir Putin ne një nga vizitat e tij zyrtare në Beograd ministri serb këndoi të famshmen “Kalinka”, këngën tradicionale të kënduar nga “Ushtria e Kuqe”.

Daçiç ka pritur me këngë edhe kryeministrin Edi Rama kur në 2014-ën shefi i diplomacisë serbe i kishte kënduar “O sole mio”. Ndonëse nuki lejoi vetës të këndonte në shqip, ai i plotësoi kërkesën Z. Rama me një këngë italiane.

